



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 17.7.2020

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR.28, DATË 2.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.88/2019, “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”, TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17 korrik 2020, shqyrtoi aktin normativ nr.28, datë 2.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar”. Komisioni e shqyrtoi aktin normativ sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Relator për këtë akt normativ u caktua z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, për të paraqitur aktin normativ dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Znj. Anila Denaj – Ministre, znj. Adela Xhemali – Zëvendësministre, znj. Mimoza Dhëmbi - Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, si dhe z. Endrit Lami - Drejtor i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale.

II. Baza ligjore.

Rishikimi i buxhetit në mes të vitit buxhetor mbështetet në:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, arsyet dhe përmbajtja e aktit normativ.

III. 1. Ndryshimet e mëparshme në buxhetin e vitit 2020.

Ndryshimi i parë i buxhetit të vitit 2020 u miratua me aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.6, datë 21.3.2020. Ky akt normativ mundësoi disa masa për të zbutur efektet e pandemisë COVID-19, si mbështetja për sektorin e shëndetësisë, shtresat në nevojë, personat e punësuar në biznese, të cilët mbetën të papunë për shkak të kësaj situatë etj. Ky akt normativ reduktoi të ardhurat e përgjithshme të buxhetit me 20 miliardë lekë, duke sjellë rritje të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik.

Ndryshimi i dytë në buxhetin e vitit 2020 u bë me aktin normativ nr.15/2020, i cili mundësoi financimin me 7 miliardë lekë të shpenzimeve për kontingjencën për paketën sociale anti-COVID”, duke përdorur si burim rialokimin e shpenzimeve, si dhe duke mos ndryshuar nivelin e të ardhurave e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit, për rrjedhojë edhe të defiçitit buxhetor. Gjithashtu, në ndryshimin e dytë u mundësua edhe mbështetja për biznesin, në formën e instrumentit të garancisë së re sovrane, në masën 15 miliardë lekë.

III.2. Akti normativ nr.28, datë 2.7.2020.

Akti normativ nr.28, datë 2.7.2020 paraqitet për miratim në situatën vijuese të emergjencës shëndetësore, të shkaktuar nga pandemia COVID-19. Prej fillimit të pandemisë, Këshilli i Ministrave ka ndërmarrë një sërë masash për t’u ardhur në ndihmë bizneseve dhe familjeve shqiptare. Masat në fushën fiskale janë koordinuar edhe me masat në fushën monetare. Vijimi i këtyre masave bëri të nevojshëm ndryshimin e tretë në ligjin për buxhetin e vitit 2020 përmes aktit normativ nr.28, datë 2.7.2020.

Qëllimi i këtij akti normativ është të mundësojë financimin e masave shtetërore për zbutjen e efekteve të pandemisë shëndetësore tek qytetarët dhe bizneset, duke parashikuar:

- alokimin e shpenzimeve në masën 7 miliardë lekë;
- miratimin e garancisë sovrane në masën 15 miliardë lekë.

Akti normativ parashikon këto ndryshime në treguesit kryesorë të buxhetit 2020:

- a) **Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit** reduktohen me 63 miliardë lekë kundrejt planit fillestar 2020, si rrjedhojë e impaktit negativ të pandemisë Covid-19, ku pjesën kryesore e zë reduktimi i të ardhurave tatimore me rreth -57 miliardë lekë.

Në krahasim me buxhetin e rishikuar me aktin normativ nr.15/2020, reduktimi i të

ardhurave është 43 miliardë lekë.

- b) **Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit** rriten me rreth 30.2 miliardë lekë, me synim kryesor financimin e sektorëve prioritarë të ekonomisë, specifikuisht përmes investimeve publike.

Në krahasim me buxhetin e rishikuar me aktin normativ nr.15/2020, rritja e shpenzimeve është 21 miliardë lekë.

- c) **Deficiti buxhetor**, për rrjedhojë, bëhet rreth -133 miliardë lekë ose rreth 8.4 për qind e PBB-së, nga përkatësisht 39.7 miliard lekë ose 2.2 për qind e PBB-së që ishte sipas buxhetit fillestar dhe nga 68.7 miliardë lekë ose rreth 3.9 për qind që ishte në buxhetin e rishikuar.

- c) **Stoku i borxhit publik**, për rrjedhojë rritet, duke arritur nivelin e pritur prej rreth 80 për qind të PBB, nga rreth 65 për qind e PBB që pritej sipas buxhetit fillestar dhe nga rreth 69 për qind e PBB në buxhetin e rishikuar.

Rritja e borxhit publik total të pritshëm, si dhe e raportit të tij ndaj PBB-së, vjen si rezultat i këtyre faktorëve:

- Rritjes së deficitit buxhetor dhe huamarrjes totale neto;
- Rritjes së stokut të pritshëm të borxhit të garantuar;
- Reduktimit të PBB nominale të parashikuar.

Rritja vetëm si rrjedhojë e reduktimit të PBB-së nominale të parashikuar nga buxheti fillestar është rreth 8 pikë përqindje.

Niveli i parashikuar i borxhit publik prej 80 për qind të PBB, nga 66 për qind e PBB që ishte vitin 2019 është në përputhje me rregullin e ri fiskal të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, të miratuar së fundmi nga Komisioni. Sipas këtij rregulli të ri, në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor lejon devijimin e përkohshëm të rritjes së nivelit të borxhit publik në krahasim me një vit më parë. Ndërkohë, në situata normale vijon të qendrojë në fuqi rregulli fiskal për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët se një vit më parë. Në periudhën afatmesme,

parashikimet janë që niveli i borxhit publik të bjerë dhe ekonomia t'i rikthehet konsolidimit fiskal.

Financimet sipas aktit normativ.

Financimet më të rëndësishme, të parashikuara në aktin normativ janë si më poshtë:

Shpenzime korrente:

- Financimi shtesë në masën 900 milionë lekë i nevojës së njërive të qeverisjes vendore për bonusin e qirasë sociale, në kuadër të tërmetit të datës 26.11.2019, deri në fund të vitit 2020.
- Alokimi i fondit shtesë prej 400 milionë lekësh për skemën e fermerëve, bazuar në tejkalimin e pritshmërive të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për aplikimet e vitit 2020.
- Financimi në masën 400 milionë lekë i programit të ri të anglishtes dhe IT-së për ciklin e ulët.
- Alokimi i një fondi prej 200 milionë lekësh, si parakusht për përthithjen e mbështetjes buxhetore të BE-së në kuadër të projekteve IPA.
- Rritja me 200 milionë lekë e fondit të planifikuar për skemën e papunësisë, si rrjedhojë e parashikimeve dhe pritshmërive deri në fund të vitit 2020.
- Sigurimi i organikës së mjaftueshme për strukturën e re të OFL-së prej 87 efektivësh, me një kosto prej 40 milionë lekësh.
- Rritja e strukturës organike të Policisë së Shtetit me 500 efektivë të rinj, pa kosto shtesë në buxhet.

Shpenzime kapitale:

- Alokimi i fondit në masën 4 miliardë lekë për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës.
- Financimi shtesë prej 1 miliard lekësh për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi.
- Alokimi i fondit shtesë prej 3 miliardë lekësh për Fondin e Zhvillimit Shqiptar, për

programe zhvillimi.

- Alokimi i fondit prej 2 miliardë lekësh për projektin madhor të Unazës së Re të Tiranës.
- Financimi i projektit të Rrugës së Ersekës, në masën 800 milionë lekë.
- Financimi prej 600 milionë lekësh i studim-projektimit të tunelit të Llogarasë.
- Financimi prej 500 milionë lekësh i studim-projektimit të konvikteve nga Bashkia Tiranë.
- Financimi i By-Pass-it Tepelenë, në masën 300 milionë lekë.
- Akordimi i një fondi prej 573 milionë lekësh për blerjen e pajisjeve dhe përshtatjen e godinës së SPAK.
- Alokimi i fondit shtesë prej 100 milionë lekësh për projektet e kanaleve ujitëse/kulluese.
- Financimi prej 73 milionë lekësh i studim-projektimit të aksit “Sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri”.

III. 3. Parashikimet për zhvillimin ekonomik deri në fund të vitit.

Goditjet që pësoi ekonomia nga tërmeti dhe pandemia COVID-19 parashikohet të japin ndikimin e tyre negativ edhe në periudhën vijuese. Si rrjedhojë, akti normativ parashikon që PBB reale të pësojë recension në masën (- 4.3) për qind, rritja nominale të jetë (-5.8) për qind, nga respektivisht 4.1 për qind dhe 5.2 për qind që ishte parashikimi në buxhetin fillestar.

Kjo rënie e ekonomisë parashikohet të ndikohet nga rënia e aktivitetit në sektorët e turizmit, transportit e tregtisë. Me rënie pritet të jenë edhe sektorët e industrisë përpunuese, industrisë nxjerrëse, shërbimeve të tjera dhe ndërtimit.

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, ndikimin më të madh negativ parashikohet ta japin eksportet, veçanërisht eksporti i shërbimeve, si dhe rënia e konsumit.

Ndryshimet e parashikuara në aktin normativ do të ndihmojnë në mbështetjen e shtresave në nevojë, si dhe kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve të tjera të rëndësishme për situatën në të cilën po kalon vendi.

IV. Diskutimi në Komision.

Ministrja e Financave paraqiti aktin normativ, duke vlerësuar nevojën dhe rëndësinë e tij, si dhe iu përgjigj pyetje të deputetëve.

Relatori paraqiti opinionin e tij për aktin normativ, duke theksuar se ai vjen si domosdoshmëri e realitetit aktual në vendin tonë, duke synuar:

- *Së pari*, orientimin e shpenzimeve në sektorët që sigurojnë mbështetjen e nevojshme për përballimin e krizës ekonomike, të shkaktuar nga dy fatkeqësitë natyrore që goditën vendin tonë;
- *Së dyti*, ndërtimin e një strategjie afatmesme, e cila synon hedhjen e hapave drejt konsolidimit fiskal të vendit.

Gjatë diskutimit, shumica e anëtarëve të Komisionit mbajtën të njejtin qëndrim me relatorin, duke e vlerësuar aktin normativ shumë të rëndësishëm për situatën në të cilën po kalon vendi ynë.

V. Përfundim.

Mbështetur në argumentet si më lart, Komisioni e miratoi aktin normativ të Këshillit të Ministrave me shumicë votash.

RELATORI

Anastas ANGJELI

KRYETARJA

Milva EKONOMI